



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 1468/Prot  
Dt. 21.03.24

217/1  
Nr. prot.

PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Shkodër, më 18.3.2024



**Lënda:** Mbi vendimin Nr.19 datë 27.02.2024 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.

### KËSHILLIT TE BASHKISE VAU-DEJES

Prefekti përcaktuar në dispozitat e ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8 germa a, neni 16, ligjit Nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" ndryshuar, neni 9 pika 1.2, germa a, dhe c, neni 27, pika 5, neni 54/e/1, neni 55/3 dhe 4 neni 64 germa c, neni 56 i KPAD,Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", Urdhërit të MB nr.175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", neni 25 i ligjit Nr.57/2020 "Për pyjet", VKM Nr.433 datë. 8.06.2016 "Per transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave , sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te ish/komunave/bashkive" i ndryshuar, pika 49, shtojca 47, VKM Nr.559 date. 29.07.2022 "Per percaktimin e cmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim /perdorim te fondit pyjor/kombetar per veprimtari ekonomike si dhen prodhime drusore dhe jo drusore pyjore", VKM Nr.888 date.27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe per ndryshim te kategorise se perdorimit,procedurat dhe dokumentacioni perkates, per ndryshimet e siperfaqeve dhe pakesimin ne volum nga fondi pyjor kombetar apo zgjerimin e tyre", Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit Nr.1/2016 "Për rregullat dhe procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", pika 22/g, Dokumentacionit të dërguar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Vau-Dejës Nr.1460prot datë.6.03.2024, *shqyrtoi vkb Vau-Dejës Nr.19 dt.27.02.2024: "Për miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes 0.03 ha dhe rrugë kalimi 0.311 km, në ngastrën pyjore Bushat-Bërdicë, për ushtrimin e veprimtarisë celulare subjektit One Albania"*.

Pas trajtimit,Prefekti ju autorizon të procedoni, konform procedurave të mëtejshme ligjore. Duke ju falenduar për bashkëpunimin.

P R E F E K T I


Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr. 19 datë 27.02.2024

**“Për dhënjen në përdorim të sipërfaqes prej 0.03 ha dhe rruge kalimi 0.311 km në ngastrën nr 15 b,ekonomia pyjore bushat berdice për ushtrimin e veprimtarise celulare subjektit One Albania”.**

Mbështetur në nenin 9 pika 1.2 germa “a”, nenit 27 pika 5, nenit 54 germa “e/l”, nenit 55 pika 3, neni 64 germa “c” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; nenin 25 të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, i ndryshuar; pikën 49, shtojca 47, të VKM-së nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar VKB-në Vau Dejës nr.7 dt. 26.01.2024, Mbi miratimin e listës së ngastrave/ nënngastrave pyjore të gatshme për dhënie në përdorim”; Udhëzimin nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I

- 1.Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej **0.03 ha** dhe **0.311 km** rruge kalimi për **ushtrimin e veprimtarise celulare subjektit One Albania në ngastrën nr 15 b,ekonomia pyjore bushat berdice.**
- 2.Afati i dhënies me qera të jetë **deri ne 5 (pese) vjet**
- 3.Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM-së **nr.559, datë 29.07.2022** “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.
- 4.Për zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- 5.Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR**

Ervis Shimaj

**SEKRETAR**

Ardian Çelepija



Miratuar me 21 vota

Vota Pro 21

Vota Kunder —

Vota Abstenim —

Zbardhur me 04.03.2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJES  
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT  
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

PROJEKT VENDIM

Nr. 03, datë 29.01.2024

“Për

**Dhënien me qira për Antenë të telefonisë celulare One Albania të sipërfaqes prej 0.03 ha dhe për rrugë kalimi 0.311 km nga prona fond “Bimësi pyjore” në ngastrën nr.15b në ekonominë pyjore Bushat Berdicë ”**

Mbështetur në nenin 9 pika 1.2, germa a dhe c, nenin 27 pika 5, nenin 54 germa e/l, nenin 55 pika 3 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Pikën 49 të VKM-së nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar; Nenin 25 të Ligjit 57/2020 “Për pyjet”, i ndryshuar; Nenin 26 të Ligjit 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”; Nenin 93 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikim elektronik në RSH”, i ndryshuar; Nenin 22/g të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik, **i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës**, ku në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ 2024 të :

VENDOSI

1. Miratimin e dhënies me qira për Antenë të telefonisë celulare One Albania të sipërfaqes prej 0.03 ha dhe për rrugë kalimi 0.311 km nga prona fond “Bimësi pyjore” në ngastrën nr.15b në ekonominë pyjore Bushat Berdicë, sipas hartës topografike të përgatitur, relacionit dhe studimit tekniko-ekonomik bashkëngjitur.
2. Afati i dhënies me qira të jetë deri në 5 (pesë) vjet.

3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.
4. Ngarkohet për zbatimin e vendimit Drejtoria e Pyjeve, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit .
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 të Ligjit nr .139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETARI**  
**Kristian Shkreli**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**ZV/KRYETARI**

**Gjovalin Zefi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT**  
**Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave**

Nr. 06 prot.

Vau Dejës, më 29.01.2024

**RELACION**

**Për dhënien me qira për antenën e telefonisë celulare ONE Albania të sipërfaqes prej 0.03 ha dhe për rrugë kalimi 0.311 km nga prona fond pyjor,ngastra nr 15b,ekonomia Pyjore Bushat Bërdicë**

**Drejtuar: Këshillit Bashkiak Vau i Dejës.**

**Të nderuar këshilltarë.**

Bashkia Vau i Dejes, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të cilët është edhe administrimi i pyjeve dhe kullotave vendore sipas mënyrës së përcaktuar me ligj ka në administrimin e saj gjithsej 31 118.2 ha. Pjesë e këtij administrimi është edhe dhënia me qera/përdorim e këtij fondi pyjor nëpërmjet të tretëve.

Kompania “Telekom Albaia Sh.a” e ndryshuar në ONE ALBANIA”, ka nënshkruar kontratën e qirase me Bashkinë Vau Dejes me një afat 5 vjeçar nga data 21.01.2018 – 21.01.2023 me nr 7168 prot datë 02.11.2018 të ciles i ka perfunduar afati.

Sipërfaqia pyjore ndodhet në Ekonominë Pyjore Bushat Bërdice, Njesia administrative Bushat.

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar pranë Bashkisë Vau i Dejës/ Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave , rezulton që parcela në të cilën është e ndërtuar kjo antenë komunikimi , është pjese e inventarit të pronave të Bashkisë Vau i Dejës , kjo bazuar në VKM nr. 433 dt 08.06.2016 i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të MM e të ish komunave/bashkive”, me nr **Ngastre 15b** dhe bën pjesë në ekonomine pyjore **Bushat Bërdice**.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”,neni 9 pika 1.2 germa a dhe c , neni 27 pika 5,neni 54 pika e1 , neni 55,pika 3është kompetencë e Këshillit të Bashkisë ,tjetërsimi apo dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr. 57/2020,datë 30.4.2020 “Për Pyjet”,neni 25, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.



Referuar udhëzimit i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika 22/g, përjashton nga konkurrimi publik dhënia e sipërfaqeve në përdorim në rastet kur persona fizik/juridikë janë të pajisur me leje/licencë nga institucionet përkatëse për veprimtaritë që kanë të bëjnë me procedurat në zbatim të ligjit për përdorimin e antenave të komunikimit radiotelevizive dhe telefonisë celulare.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria ONE ALBANIA është konform pikës 22/g dhe pikës 24 të këtij Udhëzimi dhe përbëhet nga:

- a) leja/licenca përkatëse nga institucioni qendror për ushtrimin e veprimtarisë;
- b) kontratat/marrëveshja e lidhur me autoritetin përkatës për ushtrimin e aktivitetit sipas pikës 22 të këtij udhëzimi;
- c) projektin teknik dhe grafikun e punimeve të parashikuara;
- d) hartën topografike me kordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në formatin PDF dhe në format elektronik në shkallën 1:10000 ku jenë evidentuar elementet kryesore, si: zona kadastrale sipas ZRPP-së, kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, si dhe lidhjen me të dhënat për treguesit kadastralë pyjorë dhe kullorë;
- e) lejen e mjedisit
- f) lejen e ndërtimit;
- g) aktin e regjistrimit pranë QKR-së.

Bazuar në VKM nr. 559, datë 29.07. 2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, Shtojca 1, pika 7/2 dhe 11/2 si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit si më poshtë:

7. Për vendosje antene të telefonisë fikse, të lëvizëshme, televizive, radio-komunikimit				
Nr.	Përdorimi i territorit	Siperfaqia e perdorur ne ha	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit	
			1-5 vjet	6-10 vjet
2	Tokë me Bimësi Pyjore	0.03	6,500,000	5,500,000

Në funksion të sipërfaqes që merret në përdorim, subjekti ka servitut edhe përdorimin e rrugës, sipas VKM 559, datë 29.07. 2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në

shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike dhe prodhimet drusore e jodrusore pyjore, si dhe mënyrën e procedurën e mbledhjes së tyre” tarifohen si më poshtë:

11. Për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues			
Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqia e përdorur në km	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/km/vit
2	Tokë me bimësi pyjore	0.311	30,000

**Vlera totale e pagesës/vit sipas raportit tekniko-ekonomik, 204.330 (dyqind e kater mije e treqind e tridhjetë ) lekë në vit.**

Bazuar në sa më sipër propozojmë dhënien në përdorim me afat 5 vjet për shfrytëzimin e sipërfaqes pyjore sipas të dhënave të sipërcituara.

**Bashkëlidhur po ju dërgojmë**

**1.Dokumentacionin e plotë dhe hartën e ekonomisë.**

Duke ju falënderuar, ju ftoj më në miratimin e projekt vendimit.

**Specialistët**

**Ing. Mark Suli**



**Ing. Zeqir Ujka**



**Miratoi**

**Drejtori**


**Vehbi Shkjau**






Ekonomia Pyjore Bushat Berdice

Ngastra nr.15b



Map. Zeqir Njaka   
Map. Mark Suli 